



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 14, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 17, 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

I. Me këtë Vendim, ZHVENDOSEN nga zyret e tanishme të punës 5 (pesë) Drejtoratet Komunale të cilat do të sistemohen sipas organogramit të Drejtoratit për Administratë në lokalet në pronësi komunale të cilat gjenden në kuadër të objektit të ndërtuar me koncesion -te Eurokosi në rrugën Isa Olluri Lipjan.

II. Drejtoratet Komunale të cilat do të zhvendosen me datë 04.10.2018 me krejt stafin punues, inventarin, mjetet e punës dhe dokumentacionin tjetër përcjellës janë:

1. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
2. Drejtorati për Shërbime publike
3. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
4. Drejtorati për Inspektorat
5. Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

III. Përgjegjësinë për implementimin e këtij Vendimi e ka Drejtori i Drejtoratit për Administratë.

Arsyetim

Zhvendosja e Drejtorateve të cekura bëhet me qëllim të realizimit të planifikimeve të ardhshme të Komunës të parapara me buxhetin komunal, ku planifikohet të bëhet rrënimi i barakave të vjetra të Komunës .

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi i dërgohet:

Drejtoratit për Administratë

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtorati për Shërbime publike

Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Drejtorati për Inspektorat

Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

1Nr. 030 - 61738

Lipjan, më 03.10.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

